

UDHËZIM
Nr. 1, datë 30.1.2013

**PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 22.2.2011 TË MINISTRIT TË MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE MINISTRIT TË ARSIMIT DHE SHKENCËS
“PËRCAKTIMIN E PROGRAMEVE DHE PROCEDURAVE TË ZHVILLIMIT DHE TË
VLERËSIMIT TË PROVIMEVE PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATËN E SPECIALISTIT PËR
VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE AUDITIMIN MJEDISOR”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1124, datë 30.7.2008 “Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 22.2.2011 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Përcaktimin e programeve dhe procedurave të zhvillimit dhe të vlerësimit të provimeve për pajisjen me certifikatën e specialistit për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor”, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Pas pikës 4 të shtohet pika 4/1 me përmbajtje si më poshtë:
“4/1. Komisioni i vlerësimit të provimit përbëhet si më poshtë:
a) 2 (dy) anëtarë nga fakulteti, ku do të zhvillohet provimi;
b) 2 (dy) anëtarë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
c) 1 (një) anëtar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.
 2. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me përmbajtje si më poshtë:
“5/1. Vlerësimi i provimit bëhet me sistem notash. Me certifikatë pajisen kandidatët, të cilët vlerësohen me notën 5 e lart.”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj